UDHËZIM
Nr. 22, datë 7.10.2016

MBI PËRCAKTIMIN E MASËS PËR PËRFITIMIN E PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT PERSONAL

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 42/3, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, pikave 2, 3, 16 dhe 17, të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot",

UDHËZOJ:

1. Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 2, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, është 10,287 (dhjetëmijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa "a", të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, për personat mbi 18 vjeç, është 6,172 (gjashtëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa "a", të kreut I të vendimit.

3. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa "b", të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, për personat mbi 18 vjeç, është 8,230 (tetëmijë e dyqind e tridhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa "a", të kreut I të vendimit.

4. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa "c", të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, për personat mbi 18 vjeç, është 10,287 (dhjetëmijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa "a", të kreut I të vendimit.

5. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa "ç", të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, për personat mbi 18 vjeç, është 12,344 (dymbëdhjetëmijë e treqind e dyzet e katër) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa "a", të kreut I të vendimit.

6. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa "d", të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, për fëmijët, është 4,629 (katërmijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa "a", të kreut I të vendimit.

7. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa "dh", të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, për fëmijët, është 6,173 (gjashtëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa "a", të kreut I të vendimit.

8. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa "e", të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, për fëmijët, është 7,715 (shtatëmijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa "a", të kreut I të vendimit.

9. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa "ë", të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, për fëmijët, është 9,258 (nëntëmijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa "a", të kreut I të vendimit.

10. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 16, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, për shërbimet gjithëpërfshirëse të ndihmësit personal, është 12,344 (dymbë-dhjetëmijë e treqind e dyzet e katër) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa "a", të kreut I të vendimit.

11. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 17, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, për shërbimet e herëpas-hershme të ndihmësit personal, është 8,230 (tetëmijë e dyqind e tridhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa "a", të kreut I të vendimit.

12. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 nëntori i vitit 2016 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2016, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi